



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

**SSH.06 STANDARDET E PERSONELIT AKADEMIK DHE TE
STUDENTEVE**

SSH.06.01 STANDARDET E PERSONELIT AKADEMIK

SSH.06.01.01 Standardi i pergjithshem i personelit akademik te UPT

Personeli i institucioneve të arsimit të lartë duhet te përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ.

Detyrat dhe të drejtat e personelit të UPT duhet te përcaktohen në statutin e në rregulloret e tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

SSH.06.01.02 Standardi i personelit akademik dhe titujt akademikë

Personeli akademik duhet te kryejë veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillim të institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloret e UPT dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.

Personeli akademik në UPT, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, duhet te kategorizohet në:

- a) profesorë;
- b) docentë dhe
- c) lektorë.

Në kategorinë “Profesorë” duhet te jene anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie duhet te jene gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik”.

Në kategorinë “Docentë” duhet te jene anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie duhet te jene titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”.

Në kategorinë “Lektorë” duhet te jene anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Lektorët duhet të kenë diplomë “Master i Nivelit të Dytë” dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të MASH.

Ndarja në nivele, brenda secilës kategori, emërtimi dhe renditja e tyre, si dhe kriteret më të hollësishme kualifikimi për secilin rast duhet te përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, referuar edhe përshkrimet të vendit të punës.

Numri i përgjithshëm i personelit në çdo institucion publik të arsimit të lartë duhet te miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Struktura dhe organika e personelit të UPT për të gjitha nivelet miratohet nga titullari institucionit.

Niveli i pagave, sipas kategorive dhe vendeve të punës, duhet te përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Titujt akademikë duhet te jepen nga UPT, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë. Titulli “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus” dhe “Docent” duhet te jepen nga UPT. Titulli “Profesor” duhet te jepet nga Këshilli i Vlerësimit të Titujve Akademikë.

Titulli “Akademik” duhet te jepet nga Akademia e Shkencave në përputhje me ligjin “Për Akademinë e Shkencave”.

Titulli “Docent” duhet t’u jepet anëtarëve të personelit akademik që kanë gradën shkencore “Doktor”. Ai duhet t’u jepet edhe anëtarëve të personelit akademik me diplomë “Master i Nivelit të Dytë”, ose ekuivalent i saj në vende të tjera, të vlerësuar me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyer” dhe që kanë veprimtari mësimore-kërkimore në një institucion të arsimit të lartë prej së paku 5 vitesh, përjashtuar diplomat e ekuivalentuara, sipas paragrafit të tretë të nenit 89 të Ligjit “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007.

Kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve akademikë “Docent”, “Profesor i asociuar”, “Profesor” dhe “Profesor emeritus” duhet te përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të MASH.

SSH.06.01.03 Standardi per dhenien e titullit “Docent”

Titulli “Docent” duhet t’i jepet anetareve te personelit akademik, te cilet veç kerkesave baze te dhena ne standardin e personelit akademik dhe titujt akademikë, plotesojne edhe keto kerkesa:

- a) Kane, se paku, nje vit pervoje ne mesimdhenie ne UPT, pas perfundimit te studimeve te doktorates. Kandidatet, qe kane fituar graden “Master i Nivelit te Dyte (MND)”, duhet te kene, se paku, 5 vjet pervoje ne mesimdhenie ne universitet.
- b) Kane pergatitur materiale mesimore (skripte, leksione, udhezues praktikash ose ushtrimesh) per, se paku, nje lende a modul.
- c) Kane realizuar, se paku, tre referime te shkurtera ose paraqitje (postera) ne konferenca e kongrese shkencore, nga te cilet, se paku, nje referim ose paraqitje duhet te jete mbajtur ne nje veprimtari shkencore nderkombetare (simpozium, konference, kongres), ku punimet jane pranuar ne baze te nje vleresimi paraparak shkencor dhe jane botuar ne “Proceedings”.
- d) Kane botuar, se paku, dy artikuj shkencore origjinale ose review (analiza shkencore) ne revista shkencore, nga te cilet, se paku, njeri duhet te jete botuar ose pranuar per botim ne nje reviste shkencore te huaj, te njohur, me bord editorial.

Per dhenien e titullit docent duhet te ndiqet procedura e dhene ne VKM Nr. 467, dt. 18.07.2007 “Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave per kualifikimin, shkencor dhe pedagogjik, te personelit akademik”.

SSH.06.01.04 Standardi per dhenien e titullit “Profesor i Asociuar”

Titulli “Profesor i Asociuar” duhet t’i jepet anetareve te personelit akademik, te cilet kane fituar graden shkencore “Doktor” si dhe permbushin kerkesat e meposhtme:

- a) Kane, se paku, tri vjet pervoje ne mesimdhenie (se paku, 5 vjet per lektoret e ftuar) dhe gezojne aftesi ye mire mesimdhenese. Titulli “Docent” nuk eshte parakusht per kerkimin e titullit “Profesor i Asociuar”
- b) Kane realizuar, pas doktorates, se paku, 8 referime te shkurtera ose paraqitje (postera) ne konferenca dhe kongrese shkencore, nga te cilat, se paku, pese duhet te jene mbajtur ne veprimtari shkencore nderkombetare (simpozium, konference, kongres), ku punimet jane pranuar ne baze te nje vleresimi paraparak shkencor dhe jane botuar ne “Proceedings”.
- c) Kane botuar, pas doktorates, se paku, 5 artikuj origjinale shkencore ose review (analiza shkencore) ne revista shkencore me bord editorial. Se paku, nje artikull duhet te jete botuar ne nje reviste shkencore te huaj me bord editorial, me faktor impakti.
Nje monografi shkencore, e botuar si autor i pare, ne gjuhe te huaj, qe mban numer ISBN-je, vleresohet e barabarte me deri 6 artikuj shkencore. Monografia shkencore, e botuar si autor i pare, ne gjuhen shqipe, qe mban numer ISBN-je, vleresohet e barabarte me deri 4 artikuj shkencore, te botuar brenda vendit.
- d) Kane qene titullare, se paku, te nje lende a moduli per me shume se dy vite akademike dhe kane pergatitur materiale mesimore, ne forme skriptesh, cikël leksionesh, udhezues praktikash ose ushtrimesh.

Per dhenien e titullit “Profesor i Asociuar” duhet te ndiqet procedura e dhene ne VKM Nr. 467, dt. 18.07.2007 “Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave per kualifikimin, shkencor dhe pedagogjik, te personelit akademik”.

SSH.06.01.05 Standardi per dhenien e titullit “Profesor”

Titulli “Profesor” duhet t’i jepet anetareve te personelit akademik, te cilet kane fituar graden shkencore “Doktor” si dhe permbushin kerkesat e meposhtme:

- a) Kane, se paku, pese vjet pervoje ne mesimdhenie (se paku, shtate vjet per lektoret me kohe te pjesshme) pas marrjes se titullit “Doktor”. Titujt “Docent” dhe “Profesor i Asociuar” nuk jane parakusht per kerkimin e titullit “Profesor”
- b) Gezojne aftesi te mira mesimdhenese dhe kane marre pjese aktive ne zhvillimin, akademik dhe

institucional, te institucioneve te arsimit te larte.

- c) Kane pasur nje pervoje kerkimore ose mesimdhenese prej, se paku, nje viti, ne nje institucion kerkimor-mesimor, jashte vendit. Pervoja te tilla vleresohen, kur qendrimet ne institucionet homologe jashte shtetit kane qene pa nderprerje ose edhe me nderprerje.
- d) Jane ne gjendje te mbajne, ne nivel te kenaqshem, leksione te veçanta ose cikle leksionesh, ne njerën nga gjuhët e huaja: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht dhe rusisht.
- e) Kane realizuar, si autore te pare, pas marrjes se titullit “Doktor”, se paku 15 referime te shkurtra ose paraqitje (postera) ne konferenca dhe kongrese shkencore, nga te cilet, se paku, 8 duhet te jene mbajtur ne nje veprimtari shkencore nderkombetare (simpozium, konference, kongres), ku punimet jane pranuar, ne baze te nje vleresimi paraprak shkencor dhe jane botuar ne “Proceedings”.
- f) Kane botuar, pas marrjes se titullit “Doktor”, se paku 9 artikuj shkencore origjinale ose review (analiza shkencore) ne revista shkencore, nga te cilet 4 si autore te pare, si dhe, se paku, 4 prej tyre duhet te jene botuar ose pranuar per botim ne nje reviste shkencore te huaj, te njohur, me bord editorial. Se paku dy artikuj duhet te jene botuar ne nje reviste shkencore te huaj, me faktor impakti. Nje monografi shkencore, e botuar si autor i pare, ne gjuhe te huaj, qe mban numer ISBN-je, vleresohet e barabarte me deri 6 artikuj shkencore. Monografia shkencore, e botuar si autor i pare, ne gjuhen shqipe, qe mban numer ISBN-je, vleresohet e barabarte me deri 4 artikuj shkencore, te botuar brenda vendit.
- g) Kane qene titullare, se paku, te nje lende a moduli per me shume se kater vite akademike dhe kane pergatitur materiale mesimore, ne forme skriptesh, leksionesh, udhezues praktikash ose ushtrimesh per programin mesimor te dy ose me shume lendeve a moduleve, njera prej te cilave ne ciklin e dyte te studimeve “Master”.

Per dhenien e titullit “Profesor” duhet te ndiqet procedura e dhene ne VKM Nr. 467, dt. 18.07.2007 “Per percaktimin e kriterëve dhe procedurave per kualifikimin, shkencor dhe pedagogjik, te personelit akademik”.

SSH.06.01.06 Standardi per dhenien e titullit “Profesor emeritus”

Titulli “Profesor emeritus” duhet t’i jepet profesoreve me te suksesshem, kur arrijne moshën e pensionit, sipas kriterëve te percaktuara nga MASH. Profesoreve emeritus duhet tu jepet mjedis pune ne departament, si dhe mund te thirren per leksione te veçanta ose te perfshihen ne grupe pune apo komisione. Atyre duhet t’u jepet nje shperblim mbi pensionin, masa e te cilit percaktohet me vendim te Keshillit te Ministrave.

SSH.06.01.07 Standardi per dhenien e titullit “Doctor honoris causa”

Titulli “Doctor honoris causa” duhet t’i jepet figurave te shquara te shkences, per kontribut te veçante ne zhvillimin e arsimit dhe shkences, si dhe per zhvillimin, ne teresi, te vendit tone. Ky vleresim mund te jepet nga UPT, pasi te jete marre pelqimi i Komisionit te Vleresimit te Titujve Akademike.

SSH.06.01.08 Standardi per dhenien e titullit “Akademik”

Titulli “Akademik” eshte titulli qe mund te fitoje çdo profesor, i cili eshte pranuar anetar i Akademise se Shkencave te Republikës se Shqiperise. Ne Rastin kur eshte profesor ne UPT, gezon te gjitha atributet qe i takojne titullit “Akademik”.

SSH.06.01.09 Standardi i kualifikimit shkencor dhe pedagogjik te personelit akademik

Sistemi i kualifikimit shkencor te personelit akademik duhet te perfshije studimet e doktorates dhe kualifikimin, shkencor dhe pedagogjik, pas saj.

UPT duhet te promovojë personelin akademik , te punesuar me kohe te plote per titujt: “Docent”, “Profesor emeritus”, “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”.

Per organizimin dhe drejtimin e kualifikimit, shkencor dhe pedagogjik, pas doktorates, ne fakultetet e UPT duhet te ngrihet keshilli i profesoreve

SSH.06.01.10 Standardi i personelit akademik te ftuar

Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, mund të ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.

Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.

Kritere të detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e lektorëve të ftuar duhet të përcaktohen në rregulloret e njësisë përkatëse kryesore.

SSH.06.01.11 Standardi i personelit akademik me kontratë

UPT mund të punësojë me kontratë personalitete, vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe. Ky personel duhet të punësohet me vendim të senatit akademik (REKTORIT – STATUTI), sipas propozimeve të njësisë kryesore të UPT.

UPT mund të punësojë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, edhe studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore “Doktor”, të cilët mbështesin profesorët udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor dhe gjatë kësaj periudhe duhet të trajtohen si “Lektor”.

Kriteret e punësimit të mesiperm duhet të përcaktohen në statutin dhe rregulloret e UPT, në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe aktet nënligjore rregulluese.

Shpenzimet për personelin akademik të ftuar dhe me kontrate duhet të përballohen nga të ardhurat e UPT.

SSH.06.01.12 Standardi i veprimtarive të personeli akademik

Veprimtaritë në të cilat duhet të angazhohet personeli akademik në UPT duhet të jenë:

- a) mesimdhënie;
- b) kërkim, zhvillim e transferim teknologjike;
- c) mbështetje për institucionin.

SSH.06.01.13 Standardi i llojeve të mesimdhënies

Mesimdhënia duhet të përfshijë:

- a) zhvillim të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratoreve, praktikave mesimore apo profesionale;
- b) veprimtari për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mesimdhënies: përgatitje individuale, zhvillim të kurrikulave, përpunime të materialeve didaktike dhe hartim të materialeve të reja, modernizim të metodave dhe procedurave të transmetimit dhe kontrollit të dijeve, përgatitje të materialeve didaktike nepermjet teknologjive të informacionit e komunikimit dhe përdorimi i këtyre teknologjive në veprimtari të mesimdhënies, provime, kontrole të pjesshme të dijeve, udhëheqje të teze diplome të ciklit të parë e të dytë, apo të masterave të nivelit të parë, udhëheqje të projekteve e detjave, konsultime të programuara me studentet, etj.

SSH.06.01.14 Standardi i mesimdhënies së normuar vjetore

Mesimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohe të plote, duhet të konsiderojë: zhvillimin e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratoreve, praktikave mesimore apo profesionale, të përcaktuara këtu për çdo disiplinë apo veprimtari formuese në planet mesimore të programeve të studimit. Mesimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohe të plote në fakultetet e UPT, e shprehur në ore mesimore, duhet të jetë perkatesisht:

1. Për personelin akademik të UPT

- a) Kategoria “Profesore:
 - me titullin “Profesor” 200 ore
 - me titullin “Profesor i asociuar” 220 ore

- b) Kategoria “Docente”
 - me titullin akademik “Docente” 300 ore
 - me graden shkencore “Doktor” 260 ore
- c) Kategoria “Lektore” 260 ore

2. Per autoritetet drejtuese te UPT

- a) Rektori 50 ore
- b) Kryetar i Keshillit te Administrimit 120 ore
- c) Zevendesrektor 70 ore
- d) Dekan/Drejtor instituti 70 ore
- e) Zevendesdekan/Zevendesdrejtor 150/60 ore
- f) pergjegjes departamenti/Qen. kerk. e Zhv 170/60

Mesimdhenia e normuar vjetore, per personelin akademik me kohe te plote ne fakultete, duhet te organizohet me jo me pak se 6 ore mesim ne auditor per çdo jave mesimore te vitit akademik. Mund te perjashtohen nga ky rregull deri 5% e personelit akademik te fakulteteve, sipas rregullave te percaktuara ne rregulloren e organizimit te tij. Keto perjashtime duhet te vleresohen rast pas rasti dhe miratohen ne mbledhjen e keshillit te fakultetit, mbi bazen e propozimeve te departamenteve. Nga ky rregull duhet te perjashtohet personeli akademik i instituteve dhe qendrave te kerk.e zhv.

Ora mesimore duhet te jete 60 minuta.

Elementet e mesimdhenies se normuar vjetore duhet te konvertohen ne ore mesimore, si me poshte:

- 1 ore leksion 1,5 ore mesimore
- 1 ore ushtrime/seminare 1,0 ore mesimore
- 1 ore laborator 0,8 ore mesimore
- 1 ore praktike mesimore/profesionale 0,5 ore mesimore

Mesimdhenia qe perfshin te gjitha llojet e saj, mesimdhenien e normuar vjetore dhe veprimtarite per pergatitjen e mbeshtetjen e procesit te mesimdhenies, per personelin akademik me kohe te plote ne fakultete, vleresohet gjithsej 750-1050 ore mesimore, qe i korespondon 50-70% e te gjithë fondit te kohes vjetore te punes.

SSH.06.01.15 Standardi i kerkim, zhvillim e transferim teknologjie

Veprimtarite e kerkim, zhvillim e transferim teknologjie apo veprimtarite krijuese ne UPT duhet te perfshijne:

- a) Kerkim apo veprimtari krijuese te personelit akademik, nga pjesemarrja ne programe kombetare te kerkimit dhe zhvillimit, ne programe dhe projekte kerkimore qe finalizohen me artikuj, monografi, studime dhe botime shkencore, programe doktorale, raporte progresi e perfundimtare per financuesit e programeve dhe projekteve kerkimore, organizim i veprimtarive shkencore (konferenca, seminare, kongrese, workshope, etj.) dhe pjesemarrje ne to, elemente kerkimi ne se ka ne programet e studimit te ciklit te dyte apo mastera te nivelit te dyte, krijimtari, si dhe veprimtari te tjera kerkimi apo krijuese te programuara te UPT.
- b) Veprimtari per zhvillim e transferim teknologjie te personelit akademik, apo sherbime te tjera me karakter te ngjashem, ne perputhje me programet apo strategjine e UPT, rajonale dhe kombetare te zhvillimit dhe transferimit te teknologjive, nepermjet konsultave, ekspertizes, perhapjes se njohurive shkencore e teknologjike ne mbeshtetje te biznesit dhe ekonomive lokale e kombetare, trainimit per transferime te teknologjise dhe te shkences, zhvillim per permiresim te teknologjive, si dhe veprimtari te tjera kerkimi per zhvillim apo krijuese te programuara nga UPT.
- c) Veprimtarite e personelit akademik me kohe te plote te fakulteteve, te dhena me siper, duhen te planifikohen, si rregull, jo me pak se 20% e te gjithë fondit te kohes vjetore te punes, respektivisht jo me pak se 300 ore pune vjetore.
- d) Per personelin akademik me kohe te plote te instituteve dhe qendrave te kerkimit e zhvillimit, veprimtarite e dhena me siper, duhet te planifikohen, si rregull, jo me pak se 70% e te gjithë fondit

te kohes se punes, respektivisht rreth 1050 ore pune vjetore.

SSH.06.01.16 Standardi i veprimtarise mbeshetese

Veprimtari mbeshetese per UPT, ne realizimin e misionit te tij, duhet te konsiderohen:

- a) veprimtarite per administrimin e njesive baze, kryesore dhe te institucionit, apo te programeve te ndryshme te studimit;
- b) hartimi i programeve te studimit, i rregulloreve apo dokumentacioneve;
- c) pergatitje botimesh universitare;
- d) pjesemarrje ne komisione "ad-hoc", veprimtari te senatit akademik, pjesemarrje ne keshilla, ne juri apo redaksi, pjesemarrje ne veprimtari jashte institucionit kur keto bazohen ne marreveshje, ne veprimtari promovuese te institucionit, ne mbeshetje per keshillat studentore, ne kujdestari per studentet, ne keshillim karriere, ne veprimtari te programuara ne sherbim te komunitetit lokal ose qendror, pjesemarrje ne organizata profesionale;
- e) veprimtari te tjera te percaktuara ne statutin e UPT.

Veprimtarite mbeshetese per institucionin, te dhena me siper, per personelin akademikme kohe te plote, planifikohen 150-300 ore pune, qe i korespondonjne 10-20% te gjithe fondit te kohes se punes vjetore.

SSH.06.01.17 Standardi i njehesimit ne ore mesimore te disa elementeve te veprimtareve mbeshetese

Disa nga elementet e veprimtarive per pergatitjen dhe mbeshetjen e procesit mesimor dhe veprimtarive per kerkim, duhet te njehesohen ne ore mesimore si vijon:

a) provime/mbrojtje teze diplome	0,4/0,5 ore mesimore/student
b) udheheqie teze diplome cikli I/II	15/30 ore mesimore/diplome
c) udheheqie teze diplome master niveli I/II	15/30 ore mesimore/diplome
d) udheheqie teze doktorate	90 ore mesimore/vit
e) udheheqie e projekteve te lendeve	2 ore mesimore/projekt
f) udheheqie e detyrave te lendeve	0,5 ore mesimore/detyre
g) kontrole te pjesshme te programuara te dijeve	0,3 ore mesimore/student
h) recense teze diplome cikli I/II	5/10 ore mesimore/recense
i) recense teze diplome master niveli I/II	5/10 ore mesimore/recense
j) oponente teze doktorate	20 ore mesimore/oponence
k) konsultime te programuara	deri 20 % e oreve ne auditor per leksione, ushtrime
e	seminare.

Ministri i Arsimit dhe Shkences, bazuar ne propozimin e UPT dhe ne rekomandimet e Keshillit te Arsimit te larte dhe te Shkences, propozon listen e veprimtarive te mesiperme me elemente te tjere te njehesuar te veprimtarive per kerkim, zhvillim e transferim teknologjie, per pergatitjen e mbeshetjen e procesit mesimor dhe per institucionin.

SSH.06.01.18 Standardi i kohes vjetore te punes se personelit akademik

Çdo anetar i personelit akademik me kohe te plote ne UPT duhet te permbushë detyrimet per kohen vjetore te punes me 192 dite pune (1536 ore), percaktuar kjo kohe sipas kerkesave te Kodit te Punes te republikes se Shqiperise, si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Personeli akademik me kohe te plote ne UPT mund te tejkaloje normen vjetore per mesimdhenie deri ne masen 30% pasi ka plotesuar te gjitha detyrimet e kohes vjetore te punes

Tejkalimi i paguar 30% i mesimdhenies se normuar vjetore mund te behet vetem per nevojat e institucionit dhe me miratimin nga MASH.

Organizimi i kohes vjetore te punes per personelin akademik me kohe te plote ne UPT duhet te behet ne perputhje me standardet normative te mesiperme.

SSH.06.01.19 Standardi i miratimit dhe formalizimit te programimit te mesimdhenies se normuar vjetore

dhe te kohes vjetore te punes se personelit akademik

Pergjegjesi i njesise baze, ne konsultim me anetaret e personelit akademik te saj, miraton ne mbledhjen e njesise programimin e mesimdhënies se normuar vjetore dhe te kohes vjetore te punes per secilin anetar te personelit akademik, ne perputhje me Udhëzimin Nr. 20, dt. 09.05.2008 “Per veprimtarine e personelit akademik ne institucionet publike te arsimit te larte”

Anetari i personelit akademik ka te drejte te apeloje tek Dekani/Drejtori, lidhur me shperndarjen e kohes vjetore te punes apo mesimdhënies se normuar vjetore ne veçanti. Vendimi i Dekanit/Drejtorit eshte perfundimtar.

Organizimi i kohes vjetore te punes dhe programimi i saj ne veprimtarite e ndryshne perberese, per çdo anetar te personelit akademik, formalizohet nepermjet nje marreveshjeje vjetore ndermjet pergjegjesit te njesise baze dhe anetarit te personelit akademik. Nje kopje e saj i dergohet Dekanit/Drejtorit te njesise kryesore perkatese.

SSH.06.01.20 Standardi i normave vjetore te punes per personelin akademik te ftuar

Per personelin akademik te ftuar ne njesite kryesore te UPT mesimdhënien e normuar vjetore duhet te jete deri ne 150 ore mesimore ne vit apo 150 ore pune vjetore per veprimtari kerkimore apo krijuese.

Personeli akademik i ftuar mund te thiret nga UPT kur institucioni nik ploteson nevojat per mesimdhënien nga personeli akademik i punesuar me kohe te plote ne te.

SSH.06.01.21 Standardi vitit akademik sabbatik

Personeli akademik me tituj i UPT duhet te kete të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e UPT.

Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk duhet t'i ngarkohet detyrë mësimdhëniesje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit.

SSH.06.01.22 Standardi i punësimit në UPT

Kriteret për punësim në UPT, për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ, duhet te përcaktohen në statutin e UPT. Ky personel mund te punësohet me kohë të plotë ose të pjesshme.

Kandidatët duhet te konkurrojnë në bazë të konkurseve publike. Në statutin e UPT duhet te përcaktohen procedura transparente për përzgjedhjen e kandidatit fitues, që plotëson kërkesat e publikuara dhe i përgjigjet më mirë përshkrimit të vendit të punës.

Kandidatët fitues duhet te lidhin kontratë pune me autoritetin drejtues të UPT, mbështetur në këtë Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe në “Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë”. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përshkrimeve të standardit te personelit akademik dhe titujve akademikë.

Personeli akademik me titullin “Profesor” duhet te shërbeje në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur me kërkesën e tij lirohet nga detyra.

Personelit akademik duhet t'i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë, shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statuteve dhe rregulloreve të UPT, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, si dhe dispozitave të Ligjit “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007.

Personeli ndihmes, i cili mbështet mesimdhënien apo kerkimin duhet te punesohet me kontrate ne pershtatje me Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise.

SSH.06.01.23 Standardi i statusit te personelit akademik

Personeli akademik i UPT duhet te gëzoje status të veçantë. Përveç sa parashikohet në Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007, Këshilli i Ministrave duhet te rregulloje me vendim të tij aspektet e trajtimit të veçantë dhe përfitimeve të tjera për personelin akademik.

SSH.06.01 STANDARDET E STUDENTEVE

SSH.06.01.01 Standardi i statusit te studentit

Një person duhet te fitoje statusin e studentit me regjistrimin e tij në UPT dhe duhet ta humbase këtë status me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen në bazë të Ligjit “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007, si dhe në statutin e UPT.

SSH.06.01.02 Standardi i të drejtave dhe detyrave te studentëve

Studentët duhet te kenë të drejtë:

- a) të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- b) të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga UPT;
- c) të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e UPT te parashikuar për studentë, në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007 dhe statutin e UPT;
- c) të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të UPT.

Studentët duhet te kene detyrë:

- a) të zbatojnë rregullat e hartuara nga UPT;
- b) t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- c) të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron UPT;
- c) të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në statutet ose rregulloret e UPT;
- d) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë, etj.

Në statutin e UPT përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të studentëve në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007.

SSH.06.01.03 Standardi i këshillave te studentëve

Këshillat e studentëve duhet te jene organizime te pavarura te studentëve në UPT, qe nuk zhvillojne veprimtari politike dhe ekonomike. Këshillat duhet te promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe te koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UPT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.

Këshillat e studentëve organizohen në nivel fakulteti (këshilli i studentëve të fakultetit), në nivel institucioni (këshilli i studentëve të UPT) dhe në nivel kombëtar (Këshilli Kombëtar i Studentëve).

Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë UPT. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre duhet te përcaktohen në statutin dhe rregulloret e UPT, në përputhje me Ligjin “PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, Nr. 9741. dt. 21.05.2007, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.

Këshillat e studentëve mund te shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

UPT duhet te mbështese këshillat e studentëve dhe te financojë veprimtari të tyre.

SSH.06.01.04 Standardi i kartes se studentit

Studentët e UPT duhet të pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët duhet të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

MASH duhet të përcaktojë kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit duhet të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të MASH, që mbulon UPT.

Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore duhet të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

SSH.06.01.05 Standardet e bursës për studime

Studentët e UPT duhet të përfitojnë bursa si mbështetje ekonomike për studimet e tyre, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.

Keto bursa duhet të përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacione të ligjshme. Këshilli i Ministrave duhet të përcaktojë kriteret shtetërore dhe procedurat për përfitimin e bursave.

UPT duhet të përcaktojë në statutin e tij kriteret dhe procedura për shpërblime të studentëve, që përballohen nga vetë institucioni.

Me propozimin e MASH, Këshilli i Ministrave duhet të konsiderojë dhe raste të tjera për dhënie bursash, si dhe bursa për studentë të shkëlqyer dhe shkencëtarë.

SSH.06.01.06 Standardi i kodit dhe regjistrave të studentëve

Regjistrat e amzes ekzistues në UPT duhet të realizohen konform përcaktimeve në Ligjin Nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Per arkivat” dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

UPT duhet të mbajë regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.

Regjistri i studentëve duhet të plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe të mbahet në ruajtje të përhershme. Ata duhet të organizohen në baze të njesive kryesore (fakulteti), cikli studimi dhe forme studimi.

Fakultetet e UPT duhet të kenë ndertuar bazen elektronike me të dhënat e studentëve, të listuara në shtojcën 1, bashkangjitur Urdhërit Nr. 150 të MASH, dt. 07.04.2008 “për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL”. Të dhënat e regjistrave të studentëve duhet të dërgohen në trajtë elektronike në MASH.

Kodet e regjistrave duhet të jenë sipas tabelës 1, bashkangjitur Urdhërit Nr. 150 të MASH, dt. 07.04.2008 “për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL”.

Çdo student duhet të marrë numrin e matrikullimit (NIM) që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. NIM duhet të perbehet nga 6 germa sipas regjistrave të perkates dhe 6 shifra të numrit të studentit në regjister. MASH duhet të përcaktojë rregullat për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.

UPT duhet të përgatisë rregulloren perkatese (nje kopje duhet dërgohet në MASH) për funksionimin e sistemit të matrikullimit, organizimin e punës dhe përgjegjësitë institucionale, sistemin e masave për sigurinë e të dhënave dhe monitorimin sistematik.